



STATE OF CONNECTICUT



Tetor 2024

Të nderuar prindër dhe kujdestarë,

Siguria dhe mirëqenia e fëmijëve dhe gjithkujt në shkollat tona është prioriteti ynë primar. Së fundmi, ka pasur disa kërcënime kundrejt shkollave në Konektikat, që me të drejtë ka shkakuar shqetësime ndërkohë që viti shkollor fillon - një periudhë e mbushur zakonisht me emocione dhe shpresë.

Ju lutemi vihuni në dijeni se kur shkolla e fëmijës suaj mëson rreth kërcënimeve të mundshme, mbikëqyrësit dhe stafi i shkollës janë të përkushtuar për ta ndarë informacionin, sa më shpejt që të jetë e mundur me familjet dhe komunitetin e shkollës. Megjithatë, mund të ketë kufizime për informacionin që mund të ndahet, për shkak të natyrës së ndjeshme të tij dhe nevojës për t'i mbajtur të gjithë të sigurt. Policia lokale dhe reaguesit e parë janë anëtarë të Komiteteve të Mbrojtjes dhe Sigurisë së Shkollës dhe janë të përditësuar plotësisht ndaj çdo kërcënimi të bërë. Ata punojnë ngushtë me stafin e shkollës për ta trajtuar çdo shqetësim të sigurisë.

Të gjitha shkollat në Konektikat duhet të kenë një Plan të Mbrojtjes dhe Sigurisë së Shkollës, të krijuar me informacion nga Komitetet e Mbrojtjes dhe Sigurisë së Shkollës. Planet fokusohen në pesë fusha të rëndësishme: parandalimin, mbrojtjen, zvogëlimin, reagimin dhe rimëkëmbjen. Në mënyrë të veçantë, përpjekjet shkojnë tek parandalimi, që do të thotë ndalim i dhunës përpara se të ndodhë, mbajtja e gjithkujt të përgatitur dhe të sigurt, reagim i shpejtë gjatë emergjencave dhe shkëmbim i informacionit në mënyrë efektive. Për të ruajtur sigurinë e të gjithëve, shkollat nuk ndajnë publikisht detaje specifike të planeve të tyre të mbrojtjes dhe sigurisë së shkollës.

Siguria dhe mbrojtja fillojnë në shtëpi dhe i inkurajojmë prindërit dhe kujdestarët që të na ndihmojnë me këtë. Ja ku janë disa mënyra se si familjet mund të mbështesin shkolla të sigurt:

- Jini të vetëdijshëm për aktivitetet në internet të fëmijës suaj dhe për mediat sociale dhe platformat e lojërave që përdor.
- Diskutoni seriozitetin e kërcënimeve ndaj shkollave me fëmijën tuaj, duke theksuar se nuk janë shaka të padëmshme. Kërcënime të tilla dhe raportime të rreme mund të shkaktojnë frikë dhe të çojnë në pasoja të rënda ligjore, duke përfshirë arrestimin.
- Mos lejoni që fëmija juaj të sjellë në shkollë lodra armë ose armë të tjera të rreme, pasi ato mund të duken si të vërteta, t'i frikësojnë të tjerët, të shkaktojnë ndërprerje të ditës së shkollës dhe të çojnë në masa disiplinore për fëmijën tuaj, duke përfshirë pezullimin dhe përjashtimin.
- Monitoroni informacionin personal që fëmija juaj ndan në internet, pasi mund të keqpërdoret nga të huajt në internet dhe në platformat e lojërave.
- Inkurajoni fëmijën tuaj ta raportojë në policinë lokale ose shkollë çdo kërcënim ose sjellje kërcënuese që sheh.
- Jepni shembullin e mirë në mediat sociale, pasi fëmijët mësojnë se si të sillen në internet nga të rriturit. Mos i ripostoni kërcënimet që shihni në mediat sociale, përkundrazi njoftoni policinë.
- Ligji i Konektikatit kërkon që, nëse keni armë në shtëpi, ato duhet të ruhen në vende të mbyllura në mënyrë që fëmijët të mos munden t'i arrijnë.

Faleminderit për mbështetjen tuaj të vazhdueshme. Së bashku, mund të ndihmojmë t'i mbajmë të sigurt nxënësit tanë dhe komunitetin e shkollës.

Sinqerisht,

Ned Lamont
Governator
Shteti i Konektikatit

Charlene M. Russell-Tucker
Komisioner
Departamenti Arsimit dhe Shtetit
të Konektikatit

Ronnell A. Higgins
Komisioner
Departamenti i Shërbimeve Emergjente
dhe Mbrojtjes Publike të Konektikatit